



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 460 Prot.

Tiranë, më 23.04 2018

VENDIM Nr. 76, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor "Durrësi mesjetar" 2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Dr. Elvana Metalla, Instituti Arkeologjik dhe Dr. Sonia Antonelli, Universiteti Chietit, Itali, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor "Durrësi mesjetar" 2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Dr. Elvana Metalla, Instituti Arkeologjik dhe Dr. Sonia Antonelli, Universiteti Chietit, Itali, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

Gërmimi në Amfiteatër

- Kërkimet arkeologjike në amfiteatër parashikojnë vazhdimin e gërmimit në zonën e gërmuar më parë drejt strukturave të ruajtura në lartësi, të cilat dolën në dritë pas çmontimit të shtëpive që ekzistonin aty;
- Gërmimi synon të kompletojë dokumentacionin arkeologjik në sektorin jugor të ndërtesës, si nga këndvështrimi stratigrafik ashtu edhe nga faza e transformimit dhe okupimit të ndërtesës dhe nga këndvështrimi arkitektoniko-strukturor. Për sigurinë e strukturave të mureve gjatë fazës së gërmimit synohet të përdoren konsulenca dhe bashkëpunime me Institutin e Monumenteve të Kulturës (IMK), të rënë dakord gjatë një sondazhi paraprak në amfiteatër.

2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre. brenda vitit 2018.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

